



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 35
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 13 shkurt 2019, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Drita Millaku, Haxhi Avdyli, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Miljana Nikoliq, Enver Hoti dhe Naser Rugova.

Të ftuar: Përfaqësues të Inspektoratit të Shëndetësisë, Ardita Baraku, Diana Shehu, Advije Mala, Nora Kunsani- Demjaha dhe Bashkim Vajovci.

Pjesëmarrës tjerë: Besiana Dauti, Ekonomia Online dhe Djellza Bajraliu KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 23.01.2019 dhe 29.01.2019;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit të punës;**
- 4. Takim me përfaqësues të Inspektoratit Shëndetësor;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 23.01.2019 dhe 29.01.2019.

Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 23.01.2019 dhe 29.01.2019, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit të Punës

Kryetarja Besa Baftiu: Siç e dini Projektligji i Punës ka kaluar në Qeveri dhe tashmë është në Kuvend. E dijmë që Ligji i Punës aktual është miratuar në vitin 2010 dhe ky Ligj deri në një masë e ka rregulluar kornizën ligjore sa i përket mardhënies së punës, nuk ka qenë ligj i keq për kohën që është bërë, mirëpo përpos që nuk është zbatuar, në kohën e tanishme ka nevojë që edhe të plotësohet dhe ndryshohet që të jemi konformë direktivave të BE-së, shtatëmbëdhjetë direktivat e BE-së që vijnë nga marrëdhënia e punës janë të inkorporuar në këtë ligj.

Drita Millaku tha se ne nuk vuajmë për ligje sepse kemi shumë ligje të mira, mirëpo në zbatueshmëri nuk janë duke gjetur implementim dhe duhet të bëjmë çmos që t'i shohim se sa janë duke u zbatuar këto ligje.

Kryetarja: Tek kalimi i Ligjit për Transfuzion të Gjakut, ne e kemi përcaktuar që personi që dhuron gjak t'i ketë dy ditë pushim e në ligjin aktual është një ditë dhe se ne duhet t'i bëjmë korigjimet. Ajo që tani është e nevojshme është që ne ta miratojmë në parim dhe t'ia mundësojmë Kuvendit të diskutojë dhe ne vërejtjet e tyre t'i marrim në komision dhe të punojmë rreth tyre.

Time Kadrijaj tha se ne e kemi në parim një Projektligj dhe është praktikë që sot t'i japim dritën jeshile dhe të kalojë që të miratohet në Kuvendin e Kosovës.

Ne e dijmë që është monitoruar ky ligj ku kam qenë edhe në grupin punues dhe e kemi parë që ka mangësi në zbatim dhe në implementim. Është mundësi e mirë se në grup punues do të jenë edhe përfaqësues të të gjitha subjekteve politike. Dhe unë do ta përkrahu dhe do ta votoj në parim.

Flora Brovina tha se unë votoj për këtë ligj. Mbas një kohe qofshin edhe Ligje bazike ato duhet të pësojnë ndryshime sepse edhe shoqëria pëson ndryshime, sa do që ka qenë një Ligj i cili ka vënë rregullat në punësim për herë të parë dhe ka qenë një ligj mjaft i avancuar, ai me kohë domosdoshmërisht kërkon ndryshime dhe këto ndryshime besoj që neve, si komision do t'i plotësojmë edhe me amandamentim pasi që do t'i ndëgjojmë edhe palet e interesuara të Ligjit të cilat janë të shumta, sepse mjaft aktive ka qenë edhe në të kaluarën, edhe sindikata që përfaqëson gratë në punë, pra, unë jam jo vetëm ta miratojmë një zëri, por edhe që të punojmë shumë gjatë kësaj kohe.

Fatmire Kollçaku tha se ne do ta votojmë në parim për seancë plenare ku aty do të japim komentet tona, sepse edhe me këtë ligj ka pabarazi në mes punëtorëve të sektorit privat dhe publik sepse me këtë Projektligj synohet që të mos ketë pabarazi në mes punëtorëve të sektorit privat dhe publik. Në Projektligjin për Punë e kemi obligim që dallimet t'i zvogëlojmë sepse shumica punojnë në sektorin privat dhe që nga ligji i pagave ata vazhdojnë të jenë të diskriminuar.

Bekim Haxhiu tha se në parim e mbështes këtë Projektligj që ta procedojmë për seancë është një Projektligj vuliminoz, mendoj që në Projektligjin e Punës duhet të jetë edhe pushimi i lehonisë dhe prindëror pasi që mund të ketë mos harmonizim në mes ligjeve.

Ta kemi Projektligjin e pushimit të lehonisë dhe prindëror sepse duhet të ketë harmonizim të këtij ligji me atë që të mos kemi përputhshmëri të ligjit bazik.

Kryetarja- Po është e vërtetë ajo që thoni se krahas këtij Projektligji duhet të vijë edhe Projektligji për pushimin e lehonisë edhe prindëror duke pas parasysh se njëri prej neneve e cek pushimin lindor dhe prindëror, bazohet në ligjin e pushimit të lehonisë dhe pushimin prindëror në anën tjetër, ne ende nuk e kemi atë Projektligj.

Haxhi Avdyli tha se edhe unë si përfaqësues i LDK-së në parim e përkrahi votimin e këtij Projektligji duke e parë që ky ligj është shumë i rëndësishëm për rregullimin e raportit të punës në Kosovë, mendoj që me anë të këtij Projektligji do mundohemi t'i zvoglojmë pabarazit që janë në sektore të ndryshme, e veçanërisht te sektori privat.

Duke ndihmuar që me anë të ligjit të forëcohen edhe mekanizmat kontrollues monitorues në rend të parë zbatimin e këtij ligji dhe normalisht forcimin e Inspektoratit të Punës, si një prej faktorëve që ndihmon që ky Ligj të zbatohet.

Komisioni, pas diskutimeve nga antarët e komisionit, nxori këtë:

V e n d i m

Miratohet në parim projektligji për Inspektoratin e Punë

4. Takim me përfaqësues të Inspektoratit Shëndetësor

Kryetarja: Ne jemi njoftuar prapakisht, na keni dërguar një letër po ashtu jemi njoftuar përmes mediave dhe e dijmë që keni pasur grevë lidhur me statusin tuaj si Inspektorat Shëndetësor. Ne me gjithë dëshirë do t'ju dëgjojmë dhe pastaj shofim se çfarë ne, si komision, mund t' ju ndihmojmë në këtë drejtim e keni përkrahjen tonë dhe do ta keni.

Kryeinspektorja në Inspektoratin Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë Ardita Baraku- Sa për informatë janë dhjetë profesionist shëndetësor, janë nëntë inspektor dhe unë kryeinspektore.

Për vitin 2018-të janë shqiptuar 71 gjoba, 34 mungesa të licencës dhe 1500 ankesa nga qytetarët. Në bazë të inspektimeve që janë bërë sipas inspektoratit shëndetësor më mirë gjendja është në institucionet shëndetësore publike se sa ato private, sidomos në pjesën higjienike.

Sfida kemi të llojllojshme, mirëpo me gjithëatë ne kemi arritur që t'i inspektojmë shërbimet shëndetësore në komunat me pakicë minoritare, dmth. tridhjetë komuna raportojnë çdo ditë, janë zhvilluar inspektime në qendrat korrektuese, kemi pas bashkëpunime rajonale sidomos gjatë vitit të kaluar. Me inicim të Inspektoratit Shëndetësor të Kosovës është krijuar rrjeti ballkanik i inspektorateve shëndetësore i cili udhëhiqet nga ne.

Janë disa çështje që na shqetësojnë neve, na u është kërkuar me qenë mjek të licencuar dhe jemi klasifikuar si shërbyes civil. Nuk kërkojmë pagë marramendëse, por të jemi të barabartë në sistemin publik.

Inspektore shëndetësore Diana Shehu- Devaja tha se nuk mund të vlerësohen njëjtë punëtorët me kualifikim më të dobët dhe ata më të lartë siç është bërë në rastin e tyre.

Brenga kryesore Ligji për Inspektoratin Shëndetësor, mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nuk mund ta bëjnë punëtorët me kualifikim më të ulët profesional se sa punëtori që është subjekt mbikëqyrës. Ne kërkojmë që specialisti me pas koeficient 5, ndërsa ne me pas 5.1 sepse jemi organ mbikëqyrës, kërkojnë kushte shtesë dhe të trajtohen barabartë si mjekët.

Kërkojmë të paguhet urgjenca apo gatishmëria. Nuk paguhet shujta, jemi mbikëqyrës në të gjitha institucionet në gjithë Kosovën dhe duhet ta kemi shujtën te secili mjek dhe te kujdestaria po ashtu.

Kryetarja: E keni pasur një takim me Ministrin e Shëndetësisë, a keni arritur ndonjë marrëveshje?

Inspektore shëndetësore Diana Shehu –Devaja: Ministri na ka përkrahur, gjithashtu ai na ka treguar që jemi ranguar si Inspektorat Shëndetësor me koeficient 3.5. Greva është ndërprerë se janë premtuar që 3.5 koeficient do mund të shtohen shtesa rrezikshmëria, gatishmëria, kujdestaria ama ne kërkojmë që edhe koeficienti të ngritet. Më shumë jemi të shqetësuar për koeficientin sepse shtesat mundën me u heq.

Kryetarja tha se ne, si komision, kemi bërë amendament dhe e kemi dorzuar në Komisionin Funkcional për Administratë Publike, nuk i ka marrë votat as nga Komisioni Funksional dhe gjithashtu nuk është votuar as në Kuvend dhe jeni ranguar me koeficient 3.5.

Inspektore Advije Malaj tha se me koeficientin 3.5 janë dëmtuar specialistët duke u bërë të njëjtë si me mjekët e përgjithshëm. Ligji për paga, inspektorët shëndetësorë u caktu me koeficient 3.5 që është për mjek të përgjithshëm, por ne jemi specialistë, jemi dëmtuar dhe është hendikep në punën tonë.

Fatmire Kollqaku tha se Inspektori Shëndetësor është ndër inspektoratet ku vërtet kërkohet një pregaditje shkollore, ku në rend të parë kërkohet të jetë mjek, janë pak staf dhe nga numri i stafit mund ta kuptojmë se sa pak i japin rëndësi inspektoratit.

Bekim Haxhiu tha se si komision jemi munduar që të bëjmë më të mirën, me qenë në shërbimin e juaj si të gjithë profesionistët e tjerë shëndetësorë. Ligji ka kaluar me ato të metat dhe të mirat e tij nuk është një Ligj përfekt sepse se pari juve ju godet. Sa i përket vlerësimit të punës së juaj dhe pagesave ne i kemi dhënë qëndrimet tona edhe në Komisionin Parlamentar edhe në seancë Komisioni për Administratë Publike pak ka pasur kuptime sa i përket tek çështjet e shëndetësisë, nga ana jonë do ta keni përkrahjen e vazhdueshme.

Haxhi Avdyli tha se ky Ligj për Paga që ka kaluar më shumë ka shkaktuar pabarazi dhe padrejtësi, njëri prej faktorëve që ky Ligj ka shkaktuar pabarazi jeni ju. Ne duhet ta themi që tani mundësitë janë të vogla me i përmisuar, është një mundësi nëse kthehet edhe njëherë Ligji dhe fillon diskutimi, ne i kemi bërë amendamentet, amendamentet që z. Haxhiu i ka rregulluar me detaje shumë të gjëra edhe amendamenti i Komisionit për Shëndetësi duhet të ju themi që ne këto amendamente nuk i kemi përkrahur.

Flora Borvina tha se problemi nis nga mos ardhja e Ligjit për Inspektoratin, po ta kishim pas këtë ligj sigurisht që kishim pasur më shumë mundësi që të llojmë për amendamentin e kolegut. Sa i përket Ligjit për Paga, është ligj që vjen për herë të parë dhe prandaj mund të ketë edhe shumë gabime edhe gjatë punës së madhe që është bërë kemi parë që ka gabime dhe që mund të përmisohen që pas aprovimit ta kërkojmë në plotësim ndryshimin.

Bekim Haxhiu tha se duke e ditur peshën e inspektoratit, këtu jemi koleg të gjithë dhe po flas pa parti politike dhe po flas ashtu siç ish dashur të jetë e rregulluar, nëse kthehet Ligji edhe njëherë në Kuvend që na ka munguar edhe neve si komision uniteti. Unë e kam bërë një amendament, por edhe përmbrnda partisë nuk ka pasur imunitet. Ne, si Komision, e kemi përkrahur po kot flasim diçka nëse nuk kalohet në Kuvend, po nëse kthehet Ligji ne e marrim përsipër si komision me gjet një unitet me kërkesën që koeficienti nën 5 mos me qenë.

Kryeinspektorja në Inspektoratin Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë, Ardita Baraku:

Këtu u fol që të bëhet një barasvlersim me inspektoratet e tjera nuk po e mohoj rëndësinë e cilit do inspektorat, por ne e kemi prapë një problem shtesë se ne hijmë në institucione prapë të mbrojtura që për inspektoratet e tjera nuk është gjithmonë e vlefshme.

Ajo çfarë shihet në grafikon është prezantimi numerik po nëse shihet me përqindje të institucioneve publike dhe private po flasim që janë inspektuar përfaqësisht 86% të institucioneve publike dhe 63% në private.

Nuk ka akte administrative që parashihet licensimi i institucioneve publike, dmth. akti administrative është vetëm për ato private ka qenë në bisedim me vite në ministri kjo çështja e licensimit të institucioneve publike, por nuk ekziston një akt i tillë.

Fatmire Kollaqu tha se kur është kërkuar koeficienti për mjekun specialist aty thuhet që koeficienti 5 për mjek specialist që punojnë në institucionet publike shëndetësore, atëherë bazuar në këtë pikë është që keni mundur të përfshiheni edhe ju, pikërisht statusin që e keni si shërbyes civil ju kufizon, prandaj unë mendoj që institimi juaj për me ndrruar duhet me qenë afatgjatë, jo afatshkurtër pa e ndrruar ju statusin e juaj bazuar në punët që i bëni nuk keni me mund ta dëshmoni koeficientin.

Drita Millaku tha se ne e kemi diskutuar shumë herë me koleg që Ligji për paga ka shumë mangësi, ka diskriminimin në shumicën prej institucioneve, ka edhe shumë gabime të cilat po i hasim tani edhe shumica prej institucioneve janë duke na shkruar që është bërë diskriminimin në rangitjen një ndër ta jeni edhe ju. Ligji mundet me u përmisuar, mundet me u ndryshuar. Mendoj që politikat në shëndetësi në përgjithësi kanë qenë të gabuara jo vetëm në këtë qeverisje, por edhe në qeverisjet e kaluara sepse vetë numri i inspektorëve, e në përgjithësi duke qenë i vogël tregon se sa i kanë dhënë rëndësi mu inspektuar institucionet, të cilat po mendojnë me e pasur një cilësi në punë!

Kryetarja tha se ne të gjitha këto që i folëm dhe kërkesat e juve do t'i adresojmë te ministri nëse ministri u ka thënë 50% ne do të kërkojmë që kjo të implementohet dhe të zabollet menjëherë.

5. Të ndryshme.

Kryetarja tha se e kemi një kërkesë nga Komisioni për Legjislacion ku ju ka drejtuar Komisionit për Shëndetësi që të kenë parasysh dhe të marrin iniciativën për plotësim ndryshim të Ligjit të Skemave Pensionale të Financuara nga Shteti, siç e dini këtë Ligj e kemi në agjendën legjislative dhe do të vijë për plotësim ndryshim, dhe mendoj që nuk ka pasur nevojë që komisioni tjetër të na drejtohet pa nevojë. Sepse nëse ne, si Komision, duam të ju drejtojmë një komisioni tjetër së pari duhet të shikojmë agjendën legjislative të atij komisioni.

Flora Brovina tha se të gjitha komisionet e kanë një takim të vazhdueshëm para Kryetarit të Kuvendit dhe mendoj që kjo çështja që t'i adresohemi komisioneve të tjera është e padrejtë sepse është një rregullorë tjetër që merret me përgjegjësit e komisionit. Sa i përket komisionit ad-hoc edhe pse jam anëtare e këtij komisioni nuk e kam kuptuar pse është formuar ky komision për një detyrë që e ka komisioni jonë për skemat pensionale a nuk po i besojnë komisionit bazë?

Kryetarja tha se komisioni jonë e jep fjalën e fundit, dhe nuk po e shoh që ka diçka të keqe nëse dikush na ndihmon. Sa i përket agjendës legjislative, nuk jemi vonuar në atë drejtim dhe nuk kemi pasur asnjëherë vërejte rreth punës që e bëjmë ne, si komision.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU